

VËSHTRIM

Asociacioni nuk është as Republikë e re Srpska e as OJQ

Logjika e brendshme e BE-së për këtë marrëveshje ishte të pranohej çfarëdo kompromisi i arritshëm (brenda disa linjave të kuqe të përcaktuara prej aktorëve kyç, si Gjermania dhe SHBA-ja), sepse – kompromisi është kompromis



Bodo Weber

Është tepër herët që të vlerësohet hollësishët Marrëveshja e 26 gushtit. Qysh ka ndodhur edhe me rastin e kompromiseve të mëhershme të dialogut Kosovë-Serbi "të lehtësuar" prej Bashkimit Evropian, edhe kësaj here na u tor sipas hesapit rafional - pretendimi të përbashkëta kundërthënëse prej Beogradit e Prishtinës, dhe pretendimi i përbashkët kundërthënës prej Qeverisë dë përfaqësuesve opozitarë të Kosovës.

Do të thosha se karakteri dhe ndikimi i marrëveshjes gjykohet

më së miri prej logjikës së brendshme të faktorit kyç – BE-së – si dhe prej zhvillimit të ardhshëm të asamblese serbe të komunave në kontekstin e politikës BE-SHBA. Nëse do të ulesha në zyrën e Mogherinit të punoja për kompromisin, d'tu hidhja një sy modeleve të funksioneve komunale pa krijuar një nivel të tretë të qeverisjes, do të shikoja traditën ballkanike të etnopolitikës dhe do të kombinoja atë me masterplanin perëndimore përzgjidhjen e konfliktit ndërmjet Serbisë e Kosovës dhe do t'i afrojat t'ë dyja vendet në BE si shtete demokrate dhe sovrane. Por halli është se kështu nuk funksionon BE-ja dhe politika perëndimore – së pari për shkak se nuk ka një politikë të qartë perëndimore për Serbinë-Kosovën, nuk ka farë masterplani; dhe së dyti për shkak se nuk është se kështu funksionon kultura "e lehtësimit" në Bruksel – logjika e brendshme e BE-së për këtë marrëveshje ishte të pranohej

çfarëdo kompromisi i arritshëm (brenda disa linjave të kuqe të përcaktuara prej aktorëve kyç, si Gjermania dhe SHBA-ja), sepse – kompromisi është kompromis. Kjo implikon se çështja e ndikimit afatgjatë dhe afatmesëm në demokraci dhe sundim të rendit duhet të mbetet në margjina.

Teksa analizon tekstin e marrëveshjes për parimet/elementet kryesore të Asociacionit të Komunave Serbe mund të identifikoni konturat e një garnitur institucionale unike e të ndërmjetës. Asociacioni nuk është as Republikë e re Srpska e as OJQ – më shumë bëhet fjalë për diçka ndërmjet entitetit të tretë pa vazhdimësi territoriale të kërkuar prej nacionalistëve kroatë të Bosnjës dhe një bashkësie komunash pa nivel të tretë të qeverisjes. Kështu, kjo është më pak se shtet etnik serb brenda një shteti, por nuk është e thënë se nuk do të shndërohet në të tillë të cilin nuk duhet ta lejojë Perëndimi në politikën e tij

për Kosovën në një të ardhme.

Çështja më shqetësuese e ndikimit e themelimit të një Asambleje të tillë të përcaktuara në mënyrë demokratike dhe sipas sundimit të ligjit në Kosovë – në territorin e shumicës së shqiptarëve etnikë dhe në dhjetë komunitat me shumicë serbe. Si një kompromis tipik i konstruktuar prej i Brukselit, i gjithë teksti është plot formulim që mjegullojnë linjat e qarta në kuptimin kushtetues, ligjor dhe institucional. Unë tashmë po e shoh Gjykatën Kushtetuese të Kosovës duke aprovuar shkallën e ardhshme të Qeverisë së Kosovës ndaj Asociacionit bazuar në presion politik nga partitë në pushtet të mbështetura heshtazi prej diplomatëve perëndimore. Në fund të fundit, Marrëveshja e 25 gushtit është nënshkruar prej elitave politike shqiptare të Kosovës, që qeverisirin shumicën e komunave të mëdha shqiptare në Kosovë bazuar në mekanizma dhe parime që janë

larg prej parimeve evropiane të vetëqeverisjes lokale demokratike. Zbatimi i marrëveshjes së prillit të vitit 2013 deri tash në komunitat me shumicë serbe në jug të Ibrit çoi poshtë të gjitha përpjekjet perëndimore në vetëqeverisje lokale dhe në demokracinë lokale të investuar prej pavarsësisë së Kosovës.

Kështu që, po, marrëveshja mund të cilësitet njëfarë hapë kundërthënës përrpara në politikën e SHBA-BE-së drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe për anëtarësimin e të dyja vendeve në BE. Por nuk do të shkojnë kështu punët nëse Perëndimi më në fund nis të mbledhë dëmin kolateral shkaktuar demokracisë dhe sundimit të rendit që e ka prodhuar në politikën e deritanishme të zgjidhjes-konfliktit – në vend se vetëm ta shfojë dëmin kolateral.

(Autori është bashkëpunëtor i lartë i Këshillit për Politika të Demokratizimit)

"LE MONDE", PARIS

Në Kosovë, deziluzion ndaj tutelës evropiane

Jean-Baptiste Chastand

Sikur shpeshherë në Kosovë, delegacioni i Bashkimit Evropian (BE) i ka finansuar të gjitha. Tepihun e kuq, ekranet, koktejet, kamerieret, shpërbllimet e madje edhe udhëtimin e gazetarëve evropianë (ndër të cilët edhe ky i "Le Monde") ardhur për të mbuluar njëjarin. Atë mbrëmje qershori në Prishtinë kremitojë edicioni i parë i dhënies së Çmimit përgazuar hulumtues. Dhe situatës nuk i mungon dot pikantaria.

Juria ka zgjedhur t'i ndajë Çmimin e parë një gazetari që bëri të dridheshin kancelaritë perëndimore në fund të tetorit 2014. Vehbi Kajtazi, 34 vjeç, gazetari i së përditshmes "Koha Ditore", ka shkruar shumë artikuj duke e akuzuar EULEX-in, misionin evropian të drejtësisë e të policisë, i ngarkuar për të zbatuar shtetin e së drejtës në Kosovë. Zoti Kajtazi ka bujtur një intervistë me prokuroren britanike, Maria Bamieh, që ishte akuzuar nga posti pasi kishte akuzuar disa nga homologët e vet të kishin marrë ryshfet për të bllokuar disa dosje të ndjeshme. Zonja Bamieh qortonte edhe hierarkinë e saj që nuk kishte hapur hetime përkëto faktë.

Në mikrofon, Vehbi Kajtazi buzëqesh: "Kam besuar gjithmonë në vlerat e Bashkimit Evropian, madje edhe kur kam zbuluar dyshime korruptione të EULEX-it. Dhe ky çmim tregon se unë kam pasur të drejtë", përgjëzon ai.

"Shpërbleshët puna hulumtuese, por kjo nuk do të thotë se e gjitha është e vërtetë", thotë manash një diplomat i misionit evropian.

Akuzat e zonjës Bamieh ishin tema të një hetimi juridik që implikonte së paku 20 anëtarë e ish-anëtarë të EULEX-it, por ato, në pjesën më të madhe u përgjengjeshtruan nga një raport i porositur nga Bashkimi Evropian, i cili vlerëson se EULEX-i nuk ka dashur që qëllimi i varoste hetimin. "Ky rast është trajtuar në mënyrë të mjerueshme e me këmbë, por ai nuk është ngufatur", siguron autorë i këtij raporti, juristi Jean-Paul Jacqué. "Por nëse nuk i ndiqni standarde e një hetimi, atëherë çdo gjë mbetet e dyshimtë", pajtohet ai.

Ndjenja e rrëmujës

Ky episod e ka rritur edhe më shumë ndjenjën e rrëmujës që e ka

cilat autorizonin krijimin e një Gjykatë Speciale për të gjykuar personat e dyshuar që më shumë se një vit nga ky prokuror. Në mesin e këtyre personave mund të figura e njëri i fortë i Kosovës, Hashim Thaci, 47 vjeç.

Ish-shef politik UCK-së gjatë luftës së Bashkimit Serbisë (1998-1999) dhe ministër aktual i Punëve të Jashtme pas mbajtjes së gjatë të postit të kryeministrat (2008-2014), z. Thaci është i implikuari i veçantë në raportin e Këshillit të Evropës. Ai nuk ka frikë nga asnjë dhe e përkrah arsyn e krijimit të Gjykatës Speciale, e cila "do t'i kontribuoj të ardhmes së Kosovës" dhe EULEX-in, cili ka "bërë një punë shumë të mirë". Por ai me homologët e vet në pushtet është i vetmi që mban diskurs të tillë.

Opozita, e vetme, e ka fajësuar dëshrimin e EULEX-it duke arsyetur refuzimin e votimit për këtë Gjykatë.

"Ia kanë prerë kokën sistemit tonë juridik duke e krijuar një trup tjeter që merret me dosjet e ndjeshme, ky na penguar ta ndërtojme një sistem juridik kredibil", mbrohet nënkyrjetari i Komunës së Prishtinës, Dardan Sejdiu, nga partia "Vetëven-dosje".

Ai akuzon: "Pasi i fituam zgjedhjet vendore në vitin 2013, ne i dërguam dosjet me dyshime ndaj ish-kryetarit pararendës, (tani kryeministri) në EULEX. Asgjë nuk ka ndodhur".

Nacionaliste e së majtës, partia, me krijim të saj pas luftës, ka luftuar

parimin e tutelës ndërkombëtare të vendosur atëherë nga misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Ajo tash kërkon t'i jepet fund EULEX-it dhe drejtësisë ndërkombëtare, por edhe organizimin e një referendumit për bashkim me Shqipërinë fqinje. Pra, tema këto shumë eksplozive për kancelaritë perëndimore të cilat deri më tash kanë dashur më shumë të përkrahan eliten ekzistuese

Entuziazmi eksesiv

Problemi është se kritikat e EULEX-it tashmë tejkalojnë rrëthin e të vetmes opozitë kosovare. Ish-shefi i misionit ekonomik ndërkombëtar, i cili e kishte udhëhequr këtë mision në vend nga vitet 2008-2012, Andrea Lorenzo Capussela, vlerëson se EULEX-i ka ngadalësuar qëllimisht disa hetime të ndjeshme për të mos u destabilizuar Kosova dhe udhëheqësit e saj aktualë.

"Evropianët janë përpjekur të luftojnë kundër korruptionit, por këtë e kanë bërë shumë dobët, ndërsa amerikanët nuk kishin interes për ta bërë. Nuk mund të ketë një mision që e këshillon ministrin e Drejtësisë të Kosovës dhe të nesërmen prokurorin i këtij misioni ta arrestojë këtë ministër", vlerëson Z. Capussella, autor i librit të papërkthyer në frëngjisht për korruptionin dhe ndërtimin e Kosovës.



Ndaj të gjitha këtyre qortimeve, EULEX-i përgjigjet se është pritur shumë nga ai. "Ne kemi marrë më shumë se 50 mijë sinjalizime. Qdo dojse duhet të jetë verifikuar dhe e humtuar para se t'i dërgohet një gjykatësi", arsyetohet Gabriele Meucci, shef i misionit qëkur u përuarëna ndërtesa e re madhështore e Palatit të Drejtësisë në Prishtinë, e finansuar me tri të katërtat e mijteve nga Bashkimi Evropian. Ai shpalos statistika: Gjatë gjasa të jetëve misioni ka shpallur 566 akt gjykime, nga të cilat 423 për dojset kriminale të korruptionit ose të krimeve të luftës.

Atëherë si të shpjegohet ndjenja e mosdënimit të më të fuqishmëve?

"Ka pasur një entuziazëm eksesiv të një pjesë të Kosovës. Na konsideron si çlirimtarë që do t'ë shkonim ta pastron vendin dhe hesapet e tyre politike. Por është punë zgjedhësish që të sulmohen politikanët e dyshimtë, vlerëson z. Meucci. Ne, ne jemi si mjekët që u tonë pacientëve se duhet ta lënë së piri duhanin. Po ata s'ë ndalin dot duhanin, nuk mund t'i detyrosh".

Duke pritur që të gjithë, pajtohen të thonë se misioni i EULEX-it duhet të marrë fund në qershorin e vitit 2016 dhe se nuk mund t'ë vazhdojë më kështu. Shefat e shtetëve evropiane duhet t'ë marrin një vendim në muajt e ardhshëm. "Nuk ka asnjë arsyse të mbetet nësër bëhet e njëjtë gjë", përmbladh në raportin e vet Jean-Paul Jacqué, duke kërkuar që të dërgohet në vend e vërteta e përcjellë me statistika të aferave, të "rregullave etike të përbashkëta", ose t'ë verifikohet paraprakisht e kaluar profesionalë e gjykatësve, të cilat nuk janë gjithmonë në nivel.

"Një francezi që shkon atje poshtë i duhen gjashtë muaj më shumë për të kuptuar si funksionon sistemi, është një kulturë shumë e veçantë", shpjegon z. Jacqué.

Por ai rekomandon që EULEX-i të mbetet në vend për t'ë monitoruar funksionimin e drejtësisë lokale që përballet me klane dhe me grupet kriminale të organizuara : "Nuk mund t'ë braktisni krejtësisht gjërat".

Madje edhe gazetari i "Kohës Ditore" vlerëson se nuk është e mundur që EULEX-i të ikën: "Demokracia këtu është e pakompletuar dhe prania e EULEX-it është e nevojshme për ta afroar Kosovën me BE-në", siguron Vehbi Kajtazi.